


Udhërrëfyes Praktik

Buxheti i Përgjegjshëm Gjinator në Nivel Qendror



© Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës, 2014

Autore: Nicole Farnsworth, Donjeta Morina, Dea Pallaska O'Shaughnessy, dhe Ada Shima. RrGGK dhe autoret inkurajojnë kopjimin/përdorimin dhe shpërndarjen e këtij publikimi, nëse citohet burimi origjinal.

ISBN 978-9951-8852-1-8

Printuar nga Kanun në Prishtinë, Kosovë

www.womensnetwork.org

Ky doracak është publikuar me përkrahje financiare nga GIZ.



giz Deutsche Gesellschaft
für Internationale
Zusammenarbeit (GIZ) GmbH

Përmbajtja

Akronimet.....	2
Çfarë është Buxhetimi i Përgjegjshëm Gjinator?	3
Pse të bëhet një BPGJ? Baza Ligjore... ..	5
Cilat janë përfitimet nga përdorimi i BPGJ-së?	7
Për këtë Udhëzues Praktik.....	8
Si mund ta BËJ BPGJ-në në fakt? Një Udhërrëfyes Praktik 10	
Faza 1. Analiza sipas BPGJ-së	11
Faza 2. Identifikoni qëllimet për të rritur barazinë në mes burrave dhe grave.	21
Faza 3. Integrimi i perspektivës gjinore në Dokumentin Buxhetor.....	25
Pas Fazës 3: Implementimi, monitorimi, dhe vlerësimi i përgjegjshëm gjinor	27
Çfarë ndodh me kategoritë e tjera të shpenzimeve?	28
Komunalitë	28
Mallrat dhe Shërbimet	30
Shpenzimet Kapitale	31
Pagat dhe Mëditjet	41
Sugjerime për organizimin e dëgjimeve publike në një mënyrë që promovon pjesëmarrjen e barabartë të grave dhe burrave	45
Çka nëse hasi në sfida?	49
Afatet kryesore në proceset buxhetore.....	54
A doni më shumë informata dhe mjete të dobishme? ...	55

Akronimet

BPGJ	Buxhetimi i Përgjegjshëm Gjinator
GIZ	Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH
KAB	Korniza Afatmesme Buxhetore
KASH	Korniza Afatmesme e Shpenzimeve
MPMS	Ministria e Punës dhe e Mirëqenies Sociale
QAP	Qendrat për Aftësi Profesionale
RrGGK	Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës

Çfarë është Buxhetimi i Përgjegjshëm Gjinor?

Buxhetimi i Përgjegjshëm Gjinor (BPGJ) është strategji për integrimin e perspektivës gjinore në planifikimin ekonomik dhe në buxhetin qeveritar. Me të synohet që të përvetësohet një perspektivë për **përmirësimin e barazisë** së grave dhe burrave në bazë të një analize gjinore në secilën fazë të planifikimit, programimit, dhe realizimit të buxheteve qeveritare. Andaj, një buxhet i këtillë **nuk duhet** të shihet si buxhet shtesë, por si një mënyrë **më e mirë** e planifikimit buxhetor, bazuar në informata specifike sa i përket të dy gjinive që janë përfituese të politikave dhe buxheteve të ndryshme.

Mit

BPGJ do të thotë integrimi i një linje specifike buxhetore apo sigurimi i fondeve vetëm për gra.

E vërtetë

BPGJ do të thotë planifikim dhe buxhetim më i mirë për gra DHE burra. Nuk do të thotë që patjetër të rriten fondet, por mund të rezultojë në përdorim më **efikas** të fondeve ekzistuese.

Një qasje e suksesshme e BPGJ-së (e përshkruar më poshtë në detaje) analizon ndikimet e ndryshme që politikat për gjenerimin e të ardhurave dhe ato për ndarjen e mjeteve financiare kanë ndaj burrave dhe grave, si dhe në barazinë gjinore. Bazuar në këtë analizë, në politika dhe buxhete mund të prezantohen qëllimet strategjike drejt përforcimit të barazisë gjinore.

Kjo mund të ndihmojë në rritjen e transparencës, në rritjen e efektivitetit të shpenzimeve publike, dhe të lehtësojë monitorimin e zbatimit. Procesi i analizës sipas BPGJ-së mund të ndihmojë për të kuptuar:

- Nëse grupet e ndryshme të grave dhe burrave përfitojnë nga shpenzimet publike;
- Sa janë efektive alokimet buxhetore në trajtimin e nevojave dhe prioriteteve potencialisht të ndryshme të grave dhe burrave;
- Sa është efektiv zbatimi i politikave dhe i buxheteve në arritjen e qëllimeve të përgjithshme gjinore; dhe
- Si mund të ndikojnë (pa)barazitë gjinore në arritjen e këtyre qëllimeve të përgjithshme.


Pse të bëhet BPGJ? Baza Ligjore...

- **Korniza Afatmesme e Shpenzimeve (KASH)** është dokumenti kryesor i planifikimit për politikat ekonomike të qeverisë. Qeveria e Kosovës harton KASH-in në përputhje me vizionin e zhvillimit kombëtar, i cili përfshin rritjen e qëndrueshme ekonomike; qeverisjen e mirë dhe sundimin e ligjit; zhvillimin e kapitalit njerëzor; dhe përmirësimin e mirëqenies sociale.¹ Këto qëllime për zhvillim kombëtar mund të arrihen vetëm nëse edhe gratë edhe burrat përfshihen dhe konsiderohen në planifikim dhe proceset buxhetore.
- Në përputhje me **Ligjin për Barazi Gjinore**, qeveria e Kosovës duhet të integrojë aspektin gjinor në planifikimin, implementimin dhe monitorimin e zbatimit të të gjitha ligjeve, strategjive dhe politikave si në nivel qëndror,


¹ Republika e Kosovës, Ministria e Financave, *Korniza Afatmesme e Shpenzimeve 2013-2015*, Prishtinë, Prill 2012.

ashtu edhe në nivel lokal.² Këtu përfshihen edhe proceset buxhetore. Më tej, në ndryshimet e propozuara për këtë Ligj BPGJ-ja përmendet në mënyrë specifike, dhe së shpejti mund të kërkohej nga të gjitha institucionet që në të ardhmen ta bëjnë BPGJ-në si pjesë të proceseve buxhetore.

- Ministria e Financave në **Qarkoren Buxhetore për Organizatat Qendrore Buxhetore** ka përmendur dhe ka dhënë shembuj të BPGJ-së, duke inkurajuar ministritë të ndjekin BPGJ-në.³



“Pse është e rëndësishme BPGJ-ja?”



“Transparencë, llogaridhënie, efikasitet, prosperitet, BARAZI!”

² Republika e Kosovës, Ligji për Barazi Gjinore, Ligji 2004/2, në: http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2004_2_al.pdf

³ Për të lexuar qarkoren buxhetore, vizitoni: <http://www.womensnetwork.org/documents/20140526163448382.pdf>

Cilat janë përfitimet nga përdorimi i BPGJ-së?

- 1.** Mënyra se si alokohen shpenzimet publike, mund të kontribuojë në **zvogëlimin e pabarazive gjinore** brenda një shoqërie.
- 2.** Zbatimi i suksesshëm i qasjes së BPGJ-së në kuadër të buxhetit qeveritar mund të rrisë **efektivitetin** e ndarjes së mjeteve.
- 3.** Përmirësimi i efikasitetit dhe i efektivitetit të shpenzimeve mund t'ia mundësojë qeverisë të ndajë **fonde të mjaftueshme** për realizimin e roleve dhe të përgjegjësive të cilat i ka aktualisht.
- 4.** Zyrtarët për buxhet, departamentet buxhetore, dhe institucionet në nivel komunal dhe qendror mund ta shfrytëzojnë BPGJ-në për të **komunikuar dhe arsyetuar** më mirë nevojat e departamenteve të tyre te institucionet dhe palët e tjera, duke përfshirë Ministrinë e Financave.
- 5.** Hulumtimet ndërkombëtare tregojnë se barazia më e madhe mes burrave dhe grave çon në **rritje dhe prosperitet ekonomik**.

Rreth këtij Udhëzuesi Praktik

Disa shërbyes publik kanë shprehur interesim për të kuptuar më mirë se si bëhet buxheti i përgjegjshëm gjinor **në praktikë**, dhe si mund të institucionalizohet si proces.

Me përkrahjen e GIZ, Ministria e Punës dhe e Mirëqenies Sociale (MPMS), dhe Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës (RrGGK) gjatë vitit 2014 kanë bashkëpunuar për të bërë BPGJ-në në MPMS me qëllim të ofrimit të të dhënave konkrete në dokumentin buxhetor për vitin 2015 si dhe analizën e trendeve për Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve 2015-2017.⁴ Gjatë këtij procesi, ne kemi mësuar disa strategji dhe mënyra se si BPGJ

⁴ Përderia BPGJ-ja mundet dhe duhet të përfshihet në proceset buxhetore të të gjitha ministrive, MPMS është përzgjedhur për këtë pilot studim për shkak të ndikimit që ka në një grup të madh dhe të ndryshëm të njerëzve, dhe rrjedhimisht BPGJ-ja mund të ketë ndikim të madh në jetët e tyre. Për më tepër, MPMS kishte të dhëna të disagreguara gjinore, që është e rëndësishme për analizën gjinore. RrGGK shpreson që do të bashkëpunojë me Agjencinë për Barazi Gjinore brenda Zyres së Kryeministrit për t'iu ofruar përkrahje të ngjashme ministrive të tjera në të ardhmen.


bëhet vërtetë brenda një ministrie në Kosovë. Ky Udhërrëfyes Praktik është përpiluar bazuar në përvojën tonë. Ne shpresojmë që do të shërbejë si një **shembull i mirë dhe instrument i dobishëm** për ministrinë që përdorin BPGJ.

Ky udhërrëfyes është bazuar në praktikën më të mirë ndërkombëtare mbi BPGJ dhe është adaptuar në kontekstin specifik të Kosovës nga ekspertja ndërkombëtare për BPGJ, Dr. Elisabeth Klatzer në bashkëpunim me RrGGK. Më pas, udhërrëfyesi është përpunuar duke u bazuar në përvojën tonë pozitive të bashkëpunimit me Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale.

Si mund ta BËJ BPGJ-në? Një Udhërrëfytes Praktik

Gjatë periudhës së planifikimit të buxhetit, BPGJ-ja mund të zbatohet përmes një qasjeje të thjeshtë tri-fazore, përmes së cilës perspektiva gjinore integrohet në analizat, proceset, dhe dokumentet buxhetore (shih figurën 1).

Figura 1: Qasja Tri Fazore drejt BPGJ



Tani, le t'i shikojmë detajisht secilin nga këto hapa.

Faza 1. Analiza sipas BPGJ-së

Qëllimi: Qëllimi i fazës së parë është të kuptojmë çështjet gjinore dhe boshllëqet gjinore brenda një ministrie. Me anë të një analize gjinore gjithëpërfshirëse, ministrinë mund të kuptojnë se ku është i nevojshëm ndryshimi. Në të njëjtën kohë do të ndihmojë të kuptojnë se si buxhetet dhe programet ekzistuese ndikojnë tek burrat, gratë, vajzat, dhe djemtë. Ja si ta bëni hap-pas-hapi:

Hapi 1

Analizoni situatën e grave dhe burrave, vajzave dhe djemve brenda ministrisë specifike

Analizoni numrin e grave dhe burrave, djemve dhe vajzave që kanë përfituar nga një program apo projekt i caktuar brenda departamentit apo divizionit tënd. Veçanërisht, duhet të analizohen: 1) numri i grave dhe burrave, djemve dhe vajzave brenda grupit të synuar, (p.sh. numri i të papunëve) dhe 2) numri i grave dhe burrave që kanë



“A kam përfituar unë nga programet e Ministrisë barabartë me burrat?”

përfituar nga programet ose projektet specifike (p.sh. nga shërbimet publike apo transferet). Kjo ndihmon të identifikohet nëse ka pasur ndonjë dallim në numrin e grave dhe burrave, vajzave dhe djemve që kanë marrë pjesë apo kanë përfituar nga ndonjë program i ofruar nga ju.

Tabela I tregon mënyrën se si mund të analizohen të dhënat mbi gratë dhe burrat në grupin e synuar, me qëllim që të kuptojmë situatën e grave dhe burrave në një sferë të caktuar të politikave. Këtu është përdorur shembulli i numrit të grave dhe burrave të papunë dhe i numrit që janë duke kërkuar punë. Megjithatë, tabela do të duhej të modifikohet për grupet e synuara specifike të shërbimeve apo transfereve qeveritare që analizohen.

Tabela I. Shembull i shabllonit për analizën sipas BPGJ-së të grupeve të synuara brenda një viti.

	# total i grupit të synuar	# apo % e pjesëmarrjes së grave	# apo % e pjesëmarrjes së burrave
Të papunë			
Të regjistruar si punëkërkuar			
...			

Tabela 2 paraqet një shembull të një mënyre të thjeshtë përmes së cilës mund të mbledhim të dhëna për burrat dhe gratë përfituese. Ju vetëm plotësoni këtë tabelë për secilin shërbim që ofroni.

Tabela 2. Shabllon për analizën sipas BPGJ-së të përfituesve

Lloji i shërbimit apo transferit	# total i përfituesve	# i grave	# i burrave
Shërbimi A			
Shërbimi B			
...			

Së bashku, këto dy tabela mundësojnë krahasimin e grupit të synuar me numrin e përfituesve. Për shembull, nëse numri i grave të papunësuar është më i madh se i burrave (grupi synues), por më shumë burra kanë qenë përfitues të shërbimeve të punësimit (sikurse që është gjendja në Kosovë), mund të identifikohet nevoja për adresimin e kësaj pabarazie me anë të politikave të ndryshme.

Mund të jetë e dobishme të krijoni një tabelë me numrin e përfituesve, grave dhe burrave për secilin vit. Kjo mund të na ndihmojë të identifikojmë trendet në numrin e përfituesve gjatë

kohës. Tabela 3 ofron një shembull të një tablele të tillë. Nëse është e nevojshme, kësaj tablele mund t'i shtohen edhe detaje të tjera, p.sh.: gratë dhe burrat përfitues mund të ndahen sipas moshës, nivelit të arsimimit, etnisë e kështu me rradhë.

Tabela 3. Shablloni për përfituesit, Shërbimi X, 2011-2013

Viti	# total i përfituesve	# i grave	# i burrave
2011			
2012			
2013			

Duke qenë se analiza sasiore është e dobishme, është e rëndësishme që ajo të kombinohet me analizën cilësore në mënyrë që kuptohet situata e grave dhe burrave në një fushë të caktuar. Për shembull, cilat janë arsytet për ndryshimet në situatën e grave dhe burrave në tregun e punës apo cili është roli i grave dhe burrave në punën e kujdestarisë pa pagesë?

Kutia 1. Shembull për hapin 1 nga MPMS Divizioni për Aftësi Profesionale

Kjo tingëllon mirë në teori, por të shohim një shembull konkret. Në MPMS, Divizioni për Aftësi Profesionale brenda Departamentit për Punë dhe Punësim, ofron trajnime për personat që kanë shprehur interesim për trajnime të tilla në Qendrat Rajonale për Punësim. Tabela më poshtë, sikurse Tabela 3, paraqet numrin e grave dhe burrave që kanë përfutuar nga shërbimet e ofruara nga Qendrat për Aftësi Profesionale (QAP) për vitet 2011, 2012 dhe 2013.

Viti	Gjithsej përfutues të QAP	# i grave	# i burrave
2011	3,241	1,485 (46%)	1,756 (54%)
2012	3,190	1,435 (45%)	1,755 (55%)
2013	3,279	1,443 (44%)	1,836 (56%)

Tabela tregon që pjesa më e madhe e përfutuesve për vitet 2011-2013 ishin burra. Vëreni që kemi kalkuluar edhe përqindjen e grave dhe burrave, sepse kjo mund të jetë më e lehtë për tu lexuar dhe analizuar.

Ndërkaq që shembulli i dhënë këtu është mbajtur i thjeshtë që të jetë më i kuptueshëm, kur bëhet BPGJ-ja është e rëndësishme të analizohen të gjitha informatat që janë në dispozicion. Për shembull, në *Buxhetimin drejt Mirëqenies Sociale*, MPMS dhe RrGGK kanë analizuar numrat e grave dhe burrave që kanë përfunduar programin e trajnimeve si dhe shkallën e braktisjes mes grave dhe burrave. Edhe pse këto informata duhet të mbledhen në të ardhmen, nëse do të kishte të dhëna në dispozicion, do të ishte interesante të analizonim se sa përfutues të trajnimeve kanë gjetur punë pas trajnimit. Për më shume informata, ju lutem shihni: *Buxhetimi drejt Mirëqenies Sociale*.

Hapi 2

Identifikoni alokimet buxhetore, dhe kostot e shërbimeve të ndryshme

Në hapin e dytë duhet të shikojmë buxhetin në mënyrë që t'i shohim alokimet buxhetore për shërbimet e caktuara. Ngjashëm si në tabelat 1 dhe 2, mund të shikojmë buxhetin për një vit, apo mund t'i shikojmë shpenzimet vjetore të ndara për tri vitet e fundit, nëse dëshirojmë t'i identifikojmë ndryshimet gjatë kohës. Ne mund të krijojmë një tabelë të re në të cilën mund të paraqiten shpenzimet totale për shërbimet për përfituesit femra dhe meshkuj. Nëse shumat e shpenzuara për shërbimet e konsumuara nga gratë dhe burrat janë relativisht të ngjashme, shpenzimet totale mund të pjestohen me numrin total të përfituesve që të kalkulojmë shpenzimin për person (për kokë banori). Pastaj, e kalkulojmë shumën e buxhetit që i ka shërbyer burrave dhe grave, duke shumëzuar shpenzimet për kokë banori me numrin e përfituesve gra dhe burra.

Për shembull, shih tabelën 4: në kolonën e dytë, kemi vendosur shpenzimet totale për një shërbim të caktuar për secilin vit. Në kolonën e tretë, kemi vendosur numrin total të përfituesve nga tabela 3. Në kolonën e katërt, kemi përdorur

numrin e grave dhe burrave nga tabela 3, për të kalkuluar shumën që është shpenzuar për gra, respektivisht burra. Kalkulimi mund të bëhet kështu: **shpenzimet totale ÷ # i përfituesve = shpenzimet për person**. Pastaj, **shpenzimet për person x # i grave përfituese = shpenzimet për gra**. Kjo formulë përsëritet për të kalkuluar shumën e shpenzuar për burra.

Tabela 4. Shablloni i shpenzimeve sipas gjinisë

Shërbimi	Shpenzimet totale	# i përfituesve	Shpenzuar në gra	Shpenzuar në burra
2011				
2012				
2013				

Mirret nga Tabela 3

Ndonjëherë është më e lehtë të kuptojmë dhe të analizojmë këto kalkulime nëse gjithashtu i përlogarisim shpenzimet “për kokë banori” (për person) nga 1) secili përfitues; 2) për burra, 3) për gra. Në disa raste, shpenzimet për kokë banori për gra dhe burra do të jenë të njëjta (nëse burrat dhe gratë marrin shërbimet e njëjta); por në raste të tjera do të ketë dallime në koston për kokë banori të shërbimeve për gra dhe burra. Kjo mund të

ndodhë, për shembull, nëse gratë dhe burrat mesatarisht marrin pjesë në trajnime të ndryshme për aftësi profesionale me kosto të ndryshme për kokë banori (p.sh. më shumë gra marrin pjesë në kurse për kontabilitet ndërsa më shumë burra marrin pjesë në kurse për kompjuter). Për shembull, shih tabelën 5.

Tabela 5. Shpenzimet për kokë banori

Shërbimi	Shpenzimi total	Për kokë banori	Për kokë banori - Gratë	Për kokë banori - Burrat
2011				
2012				
2013				

Tabelat 4 dhe 5 na ndihmojnë në identifikimin e boshllëkut të mundshëm gjinor në alokimin buxhetor. Kjo na ndihmon të analizojmë nëse ekzistojnë boshllëqe të rëndësishme në mënyrën se si shpenzimet kontribuojnë drejt rritjes së barazisë mes grave dhe burrave. Bazuar në këtë analizë, mund të identifikojmë se ku ka zbrazëtira gjinore në alokimet buxhetore brenda divizioneve ministrore, programeve, dhe buxheteve të aktiviteteve aktuale.

“Pra, a janë gratë të vetmet që janë të nën-përfaqësuar në të gjitha nivelet e institucioneve publike?”



“Jo. Prandaj është e rëndësishme analiza gjinore. Për shembull, të dhënat në Kosovë tregojnë që burrat nuk janë të përfaqësuar në mënyrë të barabartë në mësin e mësuesve të arsimit të ulët. Kjo mund të nënkuptojë që femijët nuk kanë burra si rol modele të mira në këtë moshë. Barazia është e nevojshme në të gjitha nivelet, për gratë dhe burrat.”

Hapi 3

Identifikoni nevojat, interesat, dhe prioritetet e përfituesve

Dy hapat e parë të analizës (Faza I) janë sasiore. Do të thotë, na tregojnë vetëm numrat. Sidoçoftë, ato jo doemos na shpjegojnë **PSE** ekzistojnë boshllëqet.

Në mënyrë që të kuptojmë pabarazitë gjinore, duhet të kryejmë edhe disa hulumtime **cilësore**. Përveç analizës sasiore, mund të jetë e dobishme që të identifikohen nevojat, interesat, dhe prioritetet e grupeve të ndryshme të përfituesve. Këtu mund të shfrytëzohen fokus grupet, intervistat, dhe pyetësorët për të mbledhur informata prej palëve relevante të interesit, përfshirë përfituesit. Mund të jetë shumë e dobishme t'i përfshijmë përfituesit në vlerësimin e programeve apo shërbimeve. Analiza gjithashtu mund të përqëndrohet në të vërejturit se kush është i përfshirë në vendimin për llojet e programeve dhe kush merr shërbime apo transfere. Kutia 2 vazhdon me shembullin prej MPMS-së. Nëse i mbledhim të gjitha këto informata, ne mund të identifikojmë ku mund të ekzistojnë pabarazitë gjinore në secilën fazë, dhe pastaj të identifikojmë se si t'i adresojmë këto pabarazi.

Faza 2 e buxhetimit të përgjegjshëm gjinor përfshinë nxjerrjen e përfundimeve nga të gjeturat e analizës gjinore në Fazën 1 me qëllim të identifikimit të mënyrave konkrete për të adresuar pabarazitë gjinore të identifikuara.

Kutia 2. Shembull i hapave 2 dhe 3 nga QAP-të

Fatkeqësisht, pasi që shpenzimet e trajnimeve në vende të ndryshme nuk janë kalkuluar, ne nuk mund të nxjerrim shumën e përafërt të shpenzuar për burra dhe gra përmes QAP-ve (sipas hapit 2, identifikimi i shpenzimeve të shërbimeve). Por, duke marrë parasysh që më shumë burra se gra kanë marrë pjesë në trajnime, ne mund të supozojmë që më shumë burra se gra kanë përfituar nga buxheti i QAP.

Për të kuptuar edhe më mirë të gjeturat, në Hapin 3 ne mund të bëjmë intervista ose fokus grupe me përfaqësues të MPMS si dhe përfitues për të kuptuar pse burrat kanë më shumë qasje në këto shërbime se sa gratë. Për shembull, intervistat ose fokus grupet me personat e regjistruar në Qendrat Rajonale të Punësimit, mund të identifikojnë arsytet se pse më pak gra se burra marrin pjesë në trajnime. Kjo do të na ndihmonte të identifikojmë se cilat aktivitete mund të ndërmerren në të ardhmen që të rrisim numrin e grave që marrin pjesë në trajnime në mënyrë që të jetë më i barabartë me numrin e burrave që vijojnë trajnimet.

Faza 2. Identifikoni qëllimet për të rritur barazinë në mes burrave dhe grave.

Në Fazën 2 të BPGJ-së, duke u bazuar në rezultatet e analizave në Fazën I, mund të caktojme objektiva dhe aktivitete për të adresuar pabarazitë e identifikuara në mes të grave dhe burrave. Duhet

të përdorim analizat sasiore dhe cilësore që të informojmë dhe formulojmë objektivat të cilat do të përfshihen në dokumentin buxhetor të ardhshëm, në mënyrë që ta përmirësojmë barazinë mes burrave dhe grave. **Objektivat** janë qëllime të matshme apo synime që i kemi dhe që mund t'i arrijmë brenda një kohe të caktuar. Ne i arrijmë objektivat përmes **aktiviteteve** apo veprimeve të ndryshme. Në mënyrë që ta masim progresin dhe të vlerësojmë nëse i kemi arritë objektivat, ne gjithashtu duhet të identifikojmë **indiktorët**. Në fazën 2, duhet të përdorim informatat nga Faza 1, të cilat do të na ndihmojnë të identifikojmë objektivat, aktivitetet, dhe indikatorët për dokumentin tonë buxhetor.

Objektivat, aktivitetet, dhe indikatorët mund të ndryshojnë, varësisht nga ministria, departamenti, apo divizioni. Gjatë krijimit të tyre, duhet të mendoni me shumë kujdes për **bazën**: kjo është pika e nisjes apo situata aktuale, para se të filloni me implementimin e buxhetit të ri, dhe politikave përkatëse. Ka shumë të ngjarë që baza të jetë e ngjajshme me numrat dhe përqindjet e identifikuar në Fazën 1.

Më pas, duhet të mendoni me kujdes për **synimin** që keni tek objektivat: çfarë numri, përqindje, apo ndryshim cilësor mund të arrini **realisht** deri në fund të periudhës buxhetore. Në mënyrë që të jeni në gjendje të matni progresin drejt arritjes së objektivës tuaj, ajo duhet të specifikojë saktësisht një numër të synuar apo ndryshim të synuar që planifikoni ta arrini. Në të kundërtën, nëse nuk keni një synim të caktuar, ju nuk do të mund të matni ndryshimet që i realizoni me buxhetin tuaj. Nëse nuk mund t'i matni dhe t'i tregoni këto ndryshime, ju mund të hasni në vështirësi në ofrimin e argumenteve të qarta për vazhdimin e financimit të linjës specifike buxhetore në të ardhmen. Se si të caktojme objektiva në mënyrë praktike, më së miri shpjegohet duke vazhduar shembullin tonë (shih Kutinë 3). Kutia ilustron një shembull të objektivave, aktiviteteve dhe indikatorëve.

“Si mund të përfitojmë të dytë në mënyrë të barabartë? Çfarë duhet të ndryshoj në mënyrën se si alokohen burimet?”



Kutia 3. Shembull i Fazës 2 nga QAP

Në shembullin e përmendur të Divizionit për Aftësi Profesionale, në Kutinë 2 kemi identifikuar që më pak gra se burra vijnë në trajnimet. Ne kemi dhënë këto rekomandime:

Objektivat:

- Rritja e numrit të grave pjesëmarrëse në trajnime.
- Të shumëfishohen llojet e trajnimeve që u interesojnë grave, në shkallësi që kërkohen nga tregu aktual i punës.

Aktivitetet specifike:

- Krijimi i një strategjie komunikimi që ka për synim specifikisht gratë dhe vajzat.
- Të krijohen kurrikula të reja që u përshtaten dhe mund të jenë të dobishme për gratë, bazuar në kërkesat e tregut aktual të punës.
- Të analizohen arsyet e nivelit më të lartë të braktisjes së trajnimeve nga gratë, duke kontaktuar personat që kanë braktisur trajnimet dhe duke i pyetur për shkaqet.

Indikatorët:

- Rritja e numrit të grave pjesëmarrëse në trajnime prej 44% në 2013, për 1% çdo vit, deri sa pjesëmarrja e grave të bëhet 50% (ose ndarja të jetë e barabartë me ndarjen e grave mes grupeve të synuara, p.sh. të papunësuarit).
- Strategjia e komunikimit që targeton gratë është krijuar.
- Trajnime të reja, të llojllojshme që u përshtaten interesave të grave ekzistojnë.
- Ekziston raporti që analizon arsyet e braktisjes së trajnimeve në mesin e grave dhe burrave, dhe ofron rekomandime të qarta.

Kur të keni hartuar objektivat specifike, aktivitetet, dhe indikatorët për dokumentin tuaj buxhetor, duhet të takoheni me akterë të tjerë që janë të përfshirë në punën tuaj, dhe të merrni opinionin e tyre nëse objektivat janë të arritshme. Ata mund të kenë sugjerime që mund t'ju ndihmojnë në formulimin më të mirë të objektivave, aktiviteteve, dhe indikatorëve. Gjithashtu, këto konsultime do t'i përfshijnë ata në proces dhe ndoshta t'ua shtojnë interesimin që të përfshihen në zbatimin e objektivave dhe aktiviteteve më vonë.

Faza 3. Integrimi i perspektivës gjinore në Dokumentin Buxhetor

BPGJ-a fokusohet në integrimin e perspektivës gjinore në proceset dhe dokumentet buxhetore. Kjo mund të bëhet përmes mënyrave në vazhdim:

- 1.** Përgatitni një paragraf që përshkruan rezultatet e analizës së BPGJ-së që do të futet në kornizën afatmesme të shpenzimeve dhe/apo në dokumentin buxhetor. Përdorni këtë paragraf për t'i dhënë shtytje objektivave tuaja dhe paraqitni dëshmi për bazën. Kjo mund të

përdoret në krijimin e një argumenti të fuqishëm për nevojën e linjës buxhetore në adresimin e pabarazive gjinore ekzistuese.

- 2.** Përfshini objektivat dhe aktivitetet, që keni përcaktuar në Fazën 2, drejtpërdrejt në KASH dhe/ose në dokument buxhetor.
- 3.** Përcaktoni indikatorët specifik që të matni progresin në objektivat për barazinë gjinore.
- 4.** Gjithashtu, mund t'i rishikoni të gjithë indikatorët ekzistues të performancës lidhur me njerëzit në përgjithësi, dhe ti riformuloni ashtu që të përfshijnë gra dhe burra në mënyrë eksplicite. Kjo nënkupton, atëherë kur është e nevojshme, specifikimin e indikatorëve të targetuar që dallojnë për gra, respektivisht për burra. Kjo mund të inkurajojë mbledhjen e të dhënave të ndara sipas gjnisë, që do të jetë e dobishme për të analizuar progresin (Faza I) dhe për të planifikuar buxhetet e ardhshme.

Pas Fazës 3: Implementimi, monitorimi, dhe vlerësimi i përgjegjshëm gjinor

Fokusi i qasjes në BPGJ përmes tri fazave është në planifikimin buxhetor dhe përgatitjen e dokumenteve buxhetore në kontekst me qasjen e performancës buxhetore. Duhet të theksohet që puna e BPGJ-së nuk mbaron me ekzistimin e dokumenteve buxhetore që përfshijnë elemente të përgjegjshme gjinore siç është shpjeguar në tri fazat më lartë. Përkundrazi, implementimi i plotë i përgjegjshëm gjinor në buxhetet dhe politikat e planifikuara është qenësore, siç janë edhe monitorimi dhe vlerësimi i rezultateve. Ky këtu nuk është fokusi, pasi që supozohet që kur qështjet janë të përfshira në dokumente dhe politika buxhetore, implementimi do të ndjekë logjikën e qasjes së performancës buxhetore në përgjithësi për të garantuar implementimin dhe monitorimin e plotë të rezultateve, përfshirë nga perspektiva gjinore.

Çfarë ndodh me kategoritë e tjera të shpenzimeve?

Deri më tani, diskutimi është përqëndruar në një metodologji të thjeshtë që mund të përdoret për të bërë një BPGJ, duke përdorur shembujt e shërbimeve publike. Megjithatë, puna me BPGJ nuk kufizohet vetëm në shërbimet publike, por mund të zhvillohet në kontekstin e llojeve të ndryshme të shpenzimeve buxhetore (dhe të ardhurave). Kategori të ndryshme të shpenzimeve kërkojnë një qasje më të ndryshme. Prandaj, në këtë kapitull janë prezentuar disa specifika se si të kryejmë një BPGJ.

Komunalitë

Mund të jetë shumë e rëndësishme të analizojmë trendet në kategorinë e shpenzimeve të komunalive pasi ato sinjalizojnë hapësirat ku ka nevojë për ndryshime buxhetore në të ardhmen. Shembulli i mëposhtëm hedh dritë në hapësirat ku ka nevojë për ndryshime në të ardhmen. Për të bërë këtë, thjesht llogarit përqindjen e buxhetit i cili shpenzohet çdo vit, dhe kërko për trende. Kjo mund të ndihmojë në planifikim më të mirë për vitet e ardhshme (shih Kutinë 4).

Planifikimi më i mirë *mund* të sjell fonde të tjera në dispozicion, që mund të rialokohen në linja të tjera

buxhetore dhe të përdoren për qëllime të tjera, drejt barazisë gjinore. Kjo mund të kontribuoj në përdorim më efektiv dhe eficient të burimeve.

Megjithatë, edhe e kundërta mund të ndodhë: të kemi shumë pak shpenzime të buxhetuara për komunalitë, p.sh, në vende që janë të rëndësishme për gratë dhe vajzat.

Kutia 4. Shembull i Komunalive në Divizionin për Aftësi Profesionale

Në Divizionin e Aftësimeve Profesionale, mund të shohim që vetëm 74% e komunalive është shpenzuar në vitin 2012 dhe 81% në vitin 2013. Kjo do të thotë që më shumë fonde janë buxhetuar, se sa që janë shpenzuar. Duke pasur parasysh kufinj të ngushtë të shpenzimeve, reduktimi i shumës së buxhetuar për komunalitë mund të sjellë rritje në linja të tjera buxhetore. Gjithashtu, duke pasur parasysh që në vazhdueshmëri janë shpenzuar më pak fonde se sa janë buxhetuar, ne mund të sugjerojmë që buxheti i paraparë në të ardhmen të zvogëlohet pak (p.sh 10,000€ më pak). Natyrisht që gjithmonë duhet të kemi parasysh edhe faktorët tjerë të jashtëm, për shembull duke përfshirë rritjen e shpenzimeve të planifikuara nga kompanitë e rrymës dhe ujit dhe/ose planet për hapjen e zyreve të reja.

Shpenzuar në 2012	Shpenzuar në 2013	Buxheti në 2014	Buxheti për 2015	Buxheti për 2016	Buxheti për 2017
46,155€ (74%)	50,387€ (81%)	62,000€	52,000€ (-10,000€)	52,000€ (-10,000€)	52,000€ (-10,000€)

Mallrat dhe Shërbimet

Edhe kategoria e shpenzimeve të mallrave dhe shërbimeve mund të analizohet nga perspektiva gjinore. Në mënyrë që të kryejmë analizën gjinore, është shumë e rëndësishme mënyra se si ministria apo organizata buxhetore mban shënime për fondet e shpenzuara.

Sa i përket blerjes së mallrave, mund të jetë e rëndësishme të analizohen furnizuesit (p.sh. nëse kompania drejtohet nga burrat apo gratë) dhe se sa vende pune janë krijuar për gratë/burrat me anë të blerjes së këtyre mallrave. Megjithatë, ndikimi i aktiviteteve të prokurimit në vende pune është vështirë të analizohet me saktësi dhe për këtë arsye nuk rekomandohet të hyjmë shumë thellë në këtë analizë. Por, prapë se prapë, për këtë mund të bëhet një hulumtim i thellë interesant nga një institut hulumtues, i autorizuar nga ndonjë ministri.

Një shembull tjetër është që disa ministri e kanë përdorur këtë linjë buxhetore për të financuar pjesëmarrjen e punëtorëve në komisione ministrorë. Zakonisht, zyrtarët publik marrin mëditje për pjesëmarrje në komisione, grupe punuese, konferenca, apo tryeza të rrumbullakëta. Është e rëndësishme që të mbahen shënime për shumën e shpenzuar për mëditje, të analizuar sipas

prespektivës gjinore. Analiza gjinore që tregon se sa kanë përfituar gratë dhe burrat nga ky kompenzim për punën shtesë që ata kanë bërë mund të nxjerr në pah pabarazitë gjinore.

Mit

Është e pamundur të bëjmë buxhetim të përgjegjshëm gjinor në lidhje me shpenzimet kapitale.

E vërtetë

Ekzistojnë mënyra të ndryshme se si perspektiva e barazisë gjinore është e rëndësishme sa i përket shpenzimeve kapitale.

Shpenzimet Kapitale

Përdorimi i buxhetimit të përgjegjshëm gjinor në lidhje me shpenzimet kapitale kërkon një qasje tjetër. Shpenzimet kapitale mund të përbëjnë një pjesë shumë të madhe të shpenzimeve dhe është shumë e rëndësishme që të analizohen në detaje nga një perspektivë gjinore. Andaj këtu është paraqitur një qasje e veçantë për analizimin e fazave të ndryshme të planifikimit dhe realizimit të shpenzimeve kapitale, disi në më shumë detaje.

Pasi që nga këto shpenzime duhet të përfitojnë të gjithë qytetarët, burrat dhe gratë, kontributi i tyre është qenësor. Është e rëndësishme të sigurohemi që gratë dhe burrat janë të përfshirë në mënyrë të barabartë në proceset e vendosjes së prioriteteve, planifikimit, zbatimit, dhe përdorimit të shpenzimeve kapitale. Gratë dhe burrat sjellin perspektiva të ndryshme në secilin hap të procesit, bazuar në atë se si ata mund t'i përdorin dhe të përfitojnë nga shpenzimet kapitale në të ardhmen. Pra, gjinia mund të vihet në konsideratë në katër fazat e ndryshme që lidhen me shpenzimet kapitale:

1. Prioritetet: Sa gra dhe burra përfshihen në marrjen e vendimeve dhe përzgjedhjen e investimeve dhe projekteve që do të financohen? A janë prioritetet të përzgjedhura në mënyrë demokratike me pjesëmarrjen e qytetarëve, apo prapa dyerve të mbyllura? Me fjalë të tjera, deri në çfarë mase marrin pjesë qytetarët në procesin e përzgjedhjes së projekteve të shpenzimeve kapitale? Deri në çfarë mase janë gratë dhe burrat vendimmarrës në këtë proces? Ja ku janë dhënë disa tabela të thjeshta të cilat ministria juaj mund t'i përdorë

për të dokumentuar dhe mbajtur shënime për këto informata.

Tabela 6. Projektet e Investimeve Kapitale: Vendosija e Prioriteteve & Përzgjedhja e Projekteve.

Viti #####							
#	Proces Përfshirës? (Po/Jo)	Konsultuar me: # i		Konsultuar me: % e		Prioritetet e shprehura ⁵	
		Grave	Burrave	Grave	Burrave	Gra	Burra
Shpenzimet kapitale për sektor [emri i sektorit apo institucionit]							
1							
2							
..							
Shpenzimet kapitale për komunë [emëro komunën]							
1							
2							
..							

2. Planifikimi: Kush ka marrë pjesë në planifikimin e shpenzimeve kapitale (prioritetet e investimeve) dhe përcaktimin e roleve (gratë,

⁵ Prioritetet e shprehura nga gratë dhe burrat janë ose në formë të projekteve, në rast se ka një listë të mundësive për zgjedhje ose alternative të shpenzimeve kapitale, ose në formë të një përshkrimi të shkurtër verbal të prioriteteve të shprehura nga gratë/burrat.

burrat, apo të dy kategoritë)? p.sh, me kë janë konsultuar për karakteristikat arkitektonike, për dizajnin e objektit që po ndërtohet, apo për atë se ku do të ndërtohet ky objekt? A janë marrë në konsideratë në mënyrë të barabartë nevojat, interesat dhe prioritetet e grave dhe burrave gjatë planifikimit të projekteve? A u janë prezantuar planet grave dhe burrave që të mund të japin sugjerimet e tyre dhe a janë marrë në konsideratë sugjerimet e tyre?

Tabela 7. Projektet e Investimeve Kapitale: Planifikimi

Viti #####						
#	Buxheti	Kanë marrë pjesë në planifikim: administrimi:		Qytetarët të përfshirë në planifikim përfshirës		Çështjet gjinore të identifikuara (përshkrim i shkurtë)
		Gra	Burra	Gra	Burra	
Shpenzimet kapitale për sektorin 1 [emëro sektorin ose institucionin]						
Projekti 1... [emri]						
Projekti 2...						
...						
Shpenzimet kapitale për sektorin 2 [emëro sektorin ose institucionin]						
Projekti 1... [emri]						
Projekti 2...						
...						

3. Zbatimi: Kush i ka zbatuar ose ndërtuar projektet e investimit? A kanë qenë gratë dhe burrat të përfshirë në mënyrë të barabartë si punëtorë në të gjitha nivelet dhe a kanë përfituar në mënyrë të barabartë nga cilado pozitë e re e punës së krijuar?

Tabela 8. Implementimi/Aktivitetet e Ndërtimit

Viti #####						
#	Buxheti	Kontraktorët: Pronë e:		Numri i punëtorëve		Cilat nevoja të grave dhe burrave janë adresuar gjatë ndërtimit?
		Grave	Burrave	Gra	Burra	
Projekti 1 [emri]						
Projekti 2						
...						
...						

4. Përdorimi: Kush ka gjasa t'i përdorë ose të përfitojë më së shumti nga projektet e përfunduara (burrat, gratë, apo të dy grupet)? A hasin në ndonjë sfidë të veçantë gratë ose burrat gjatë përdorimit të tyre? Për shembull, a është një sallë sportive e kufizuar që të përdoret vetëm nga klubet e futbollit dhe sportet tjera të dominuara nga burrat, apo është e konstruktuar

si një kompleks sportiv për përdorime të ndryshme ku ka hapësirë edhe për një gamë më të gjërë sportesh?

Table 9. Përdorimi i Projekteve/Objekteve të ndëtuara përmes Investimeve.

#	Numri i përdoruesve :		Numri i punëtorëve (nëse ka)		Çështjet gjinore që janë identifikuar gjatë përdorimit (prej grave/burrave)
	Gra	Burra	Gra	Burra	
Projekti i realizuar 1 [emri]					
Projekti i realizuar 2					
...					

Pjesëmarrja e grave dhe burrave mund të analizohet në secilën prej këtyre fazave që lidhen me shpenzimet kapitale. Së pari, mund të shohim se si gratë dhe burrat kanë qenë të përfshirë në secilën prej këtyre fazave në të kaluarën, dhe të përdorim këto informata për të mësuar se si duhet të përfshihen ato në të ardhmen.

Prandaj, është me rëndësi të mbajmë shënime të këtyre informatave për secilin shpenzim kapital.

Po të mblidhen këto informata, atëherë mund të identifikohen më lehtë çështjet potenciale gjinore dhe të identifikohet mënyra se si të adresohen ato.

Pastaj, ministritë gjithashtu mund të specifikojnë objektivat, aktivitetet dhe indikatorët që lidhen me shpenzimet kapitale. Më poshtë keni disa shembuj:

“Tingëllon mirë, por problemi është që gratë nuk janë të afta fizikisht për të kryer punë të rënda, si në instalimin e gypave të ujit apo në ndërtimin e objekteve.”

“Kjo nuk është e vërtetë! Ka shumë gjëra të cilat unë mund t'i bëj, si mbajtja e shenjave të sinjalistikës në zonat e ndërtimit, të jem arkitekte, të menaxhoj punëtorët, të lyej muret, dhe shumë gjëra të tjera gjithashtu! Pse duhet të përfitosh ti më shumë se unë prej këtyre parave publike?”



Objektivat:

- Siguroni pjesëmarrje të barabartë (50%) të grave dhe burrave të prapavijave të ndryshme në identifikimin dhe **vënien e prioriteteve** për projektet e shpenzimeve kapitale.
- Siguroni pjesëmarrje të barabartë (50%) të grave dhe burrave të prapavijave të ndryshme në **planifikimin** e shpenzimeve kapitale, dhe sigurohuni që nevojat, interesat, dhe prioritetet e grave dhe burrave të merren në konsideratë gjatë procesit të planifikimit.
- Me qëllim të sigurimit të pjesëmarrjes së barabartë, rriteni përqindjen e grave të punësuar në realizimin (ndërtimin) e projekteve të investimeve prej #% në #% çdo vit (vendosni numrat). *(Shënim: Këtu po ju referohemi grave pasi që gratë zakonisht janë më pak të përfaqësuara në mesin e personave të kontraktuar për punë publike, në krahasim me burrat. Megjithatë, ju duhet ta adaptoni këtë që të përputhet me situatën reale në ministrinë tuaj, bazuar në të gjeturat në Fazën e I, Analiza Gjimore).*
- Sigurohuni që gratë dhe burrat mund të përdorin projektet e investimeve të realizuara në mënyrë të barabart.

Aktivitetet:

- Organizoni takime publike për të diskutuar, identifikuar dhe **përzgjedhur** shpenzimet kapitale, në orare dhe vende të përshtatshme për gratë dhe burrat. Promovoni sa më shumë ato për të siguruar pjesëmarrje më të madhe dhe moderoni takimet sa më mirë për të siguruar pjesëmarrje cilësore të të gjithëve.
- Organizoni takime publike për të rishikuar **planet** e shpenzimeve në orare dhe vende të përshtatshme për burrat dhe gratë. Promovoni sa më shumë ato për të siguruar pjesëmarrje më të madhe dhe moderoni takimet sa më mirë për të siguruar pjesëmarrje cilësore të të gjithëve. Sigurohuni që perspektiva gjinore të përfshihet në aktivitetet e planifikimit, me fokus të veçantë në përfshirjen e nevojave dhe interesave të përdoruesve të ardhshëm të gjinisë femrore dhe mashkullore.
- Gjatë thirrjeve për oferta, kërkoni prej kontraktorëve që të punësojnë/përfshijnë një përqindje të caktuar të të punësuarve gra dhe burra në secilin nivel të punës (së paku 40% sipas Ligjit për Barazi Gjinore), drejt rritjes së barazisë gjinore në këto projekte të financuara nga shteti. Poashtu, kërkoni prej kontraktorëve

që t'i ruajnë këto të dhëna dhe t'i dërgojnë nëpër komuna. Kërkoni prej konkurrentëve që të kenë rregullore dhe procese të gatshme kundër ngacmimeve seksuale dhe ti zbatojnë ato.

- Monitoroni përdorimin e rezultateve të shpenzimeve kapitale. Zhvilloni intervista me përdoruesit për të parë nëse punët/prodhimet e krijuara përputhen me nevojat e tyre dhe ndani këto informata sipas gjinisë.

Indikatorët:

- 50% e pjesëmarrësve të përfshirë në **identifikimin** e prioriteteve për shpenzimet kapitale janë burra, dhe 50% janë gra.
- 50% e pjesëmarrësve të përfshirë në **planifikimin** e prioriteteve për shpenzimet kapitale janë burra, dhe 50% janë gra.
- Përqindja e grave pjesëmarrëse në **zbatimin** e shpenzimeve kapitale rritet prej #% në #% për çdo vit (vendosni numrat).
- Gratë dhe burrat i **përdorin** në mënyrë të barabartë rezultatet e shpenzimeve kapitale.

Pagat dhe Mëditjet

Të dhënat lidhur me të punësuarit të ndara sipas gjinisë mund të përdoren për të identifikuar pabarazitë gjinore në punësim, në nivelin e pagave, dhe potencialiesh në ofrimin e shërbimeve. Për shembull, kategoria e shpenzimeve “pagat dhe mëditjet” përfshin fondet për të punësuarit në MPMS. Tabela 10 tregon të dhënat mbi të punësuarit të ndara sipas gjinisë, duke shikuar shifrat e grave dhe burrave të punësuar në të gjitha nivelet e MPMS.

Tabela 10. Gratë dhe burrat e punësuar në MPMS

Viti	# i të punësuarve	# i grave	# i burrave
2011	901	407 (45%)	494 (55%)
2012	914	411 (45%)	503 (55%)
2013	866	389 (45%)	477 (55%)

Tabela tregon që burrat në mënyrë të vazhdueshme përbëjnë numrin më të madh të punëtorëve (55%) në MPMS për vitet 2011, 2012, dhe 2013. Poashtu mund të identifikojmë pabarazitë në nivelet në të cilat punojnë anëtarët e stafit duke analizuar numrin e grave dhe burrave që janë të punësuar në pozita vendimmarrëse, dhe që paguhen më mirë në ministri, krahasuar me numrin

e grave dhe burrave në pozita fillestare. Nëse një numër i pabarabartë i grave ose i burrave shërbejnë në role vendimmarrëse, kjo direkt ndikon në mundësitë e grave dhe burrave që të marrin pjesë në vendimmarrje, si dhe në pagat dhe mëditjet e tyre. Më tutje, poashtu kjo mund të ndikoj në mënyrën se si politikat dhe programet e ministrisë marrin në konsideratë prioritetet dhe nevojat, potencialisht të ndryshme, të grave dhe burrave.

Në vazhdim, mund të përlogarisim përqindjen e buxhetit të shpenzuar për gratë dhe burrat duke i analizuar shpenzimet për gratë dhe burrat e punësuar në ministri. Tabela I I tregon shpenzimet e kësaj kategorie të veçantë shpenzimesh në MPMS për gratë dhe burrat dhe përqindjen e linjës buxhetore të shpenzuar në gra dhe burra çdo vit.

Tabela I I. Totali dhe përqindja e pagave dhe mëditjeve të MPMS të shpenzuara në gra dhe burra

Viti	Të shpenzuara për gratë	% e shpenzuar për gratë	Të shpenzuara për burrat	% e shpenzuar për burrat
2011	€1,563,642	43%	€2,099,127	57%
2012	€1,578,311	42%	€2,147,481	58%
2013	€1,654,029	44%	€2,143,054	56%

Tabela 11 tregon që në përgjithësi në MPMS, një përqindje më e madhe e pagave dhe mëditjeve kanë shkuar tek burrat (56-58%). Pse përqindja e pagave dhe mëditjeve që i shkon burrave është më e madhe se numri i burrave në mesin e të punësuarve në Tabelën 10 (55 % burra)? Kjo mund të kuptohet duke analizuar nivelet e pagave sipas gjinisë (për shembull në vitin 2013).

Tabela 12. Numri dhe përqindja e grave dhe burrave në MPMS sipas nivelit të pagës mujore

Niveli i pagës mujore	Burrat	% e burrave	Gratë	% e grave
200-400€	348	49%	357	51%
401-600€	135	67%	67	33%
601+ €	14	100%	0	0%

Tabela 12 tregon që më shumë burra, se sa gra, bëjnë pjesë në kategoritë e pagave më të larta. Fakti që asnjë grua nuk shërben në pozitat që kanë paga të larta është një çështje kyçe gjnore që duhet të adresohet përmes proceseve të punësimit dhe promovimit.

Pasi kuptuam që përqindja më e madhe e pagave dhe mëditjeve i shkon burrave, mund të identifikojmë objektivat, aktivitetet dhe indikatorët për të adresuar këtë çështje:

Objektivat:

- Të ulet dallimi në paga në mes të burrave dhe grave.
- Të rritet numri i grave të punësuar në nivele të larta të pagesave brenda ministrisë.

Aktivitetet specifike:

- Krijimi i politikave afirmative të veprimit dhe programeve të mentorimit të cilat inkurajojnë më shumë gra që të jenë në gjendje të arrijnë pozita më të larta brenda ministrisë.
- Inkurajim i grave që të aplikojnë për pozitat e pagave më të larta.
- Ndërmarrja e aktivitete që promovojnë gratë në pozita më të larta brenda ministrisë.

Indikatorët:

- Ulet dallimi në paga në mes të grave dhe burrave nga 1% çdo vit, prej 56% të buxhetit që shkonte për burrat në vitin 2013.
- Përmirësohet balanci i numrit të grave dhe burrave të punësuar në të gjitha nivelet në MPMS.

Sugjerime për organizimin e dëgjimeve publike në një mënyrë që promovon pjesëmarrjen e barabartë të grave dhe burrave

Përderisa deri më tani fokusi ka qenë në atë se si “të bëjmë BPGJ-në”, përfshirë edhe kategoritë specifike të shpenzimeve, ky seksion ndryshon fokusin tek disa mënyra specifike për përfshirjen e grave dhe burrave në procesin e buxhetit. Përgjatë procesit të pregaditjes së draft buxhetit, të dhënat nga qytetarët duhet të mblidhen përmes dëgjimeve publike. Kjo duhet praktikuar para draftimit të buxhetit, por edhe posa të kemi krijuar draftin fillestar të buxhetit, me qëllim të mbledhjes së të dhënave nga qytetarët.

Sigurohuni që të **reklamoni** sa më mirë këto dëgjime publike, temën e tyre, vendin, datën dhe kohën. Për të reklamuar dëgjetimet publike përdorni gazetatat, radion, televizionin, broshurat, posterat, Facebook-un, dhe shenjat nëpër ndërtesa publike dhe biznese (p.sh. dyqane). Ju poashtu mund të arrini të adresoni personalisht këtë çështje tek gratë (dhe burrat) në vendet ku ata ndodhen në jetën e tyre të përditshme. Informoni organizatat e shoqërisë civile dhe kërkoni ndihmën nga ata për

informimin e anëtarëve dhe përfituesve të tyre lidhur me takimet në mënyrë që edhe ata të mund të marrin pjesë.

Për t'u siguruar që gratë dhe burrat **marrin pjesë** në dëgjime publike, duke sjell perspektivën dhe idetë e tyre, mundohuni që t'i organizoni këto takime në një orar të përshtatshëm në të cilin gratë dhe burrat mund të marrin pjesë (p.sh. jo në kohën kur ndodh përgaditja e ushqimeve, kur njerëzit janë në punë, apo në orët e vona të natës që mund të paraqesë probleme të sigurisë për gratë).

Poashtu, sigurohuni që dëgjimet publike t'i organizoni në një vend ku të gjithë qytetarët kanë qasje dhe ndihen të rehatshëm. Për shembull gratë mund të kenë më shumë qasje në dëgjimet publike të organizuara nëpër shkolla dhe kështu mund të rritet pjesëmarrja e tyre. Mundohuni të mbani takime edhe jashtë Prishtinës për tu siguruar që keni marrë të dhëna nga qytetarë të ndryshëm. Nëse takimet mbahen më larg dhe është e dëshirueshme që të ketë pjesëmarrje të balancuar, mund të jetë me rëndësi që të mundësohet transporti.

Nëse grupe të caktuara, p.sh. gratë, nuk janë të mësuar të flasin në takime publike, konsideroni mundësinë e takimit me gratë ndaras, ku ato

ndihen më rehat që të flasin për prioritetet dhe interesat e tyre, dhe ku ato kanë gjasa të përzgjedhin disa folës për të paraqitur në takimin e përgjithshëm çështjet e diskutuara.

Prezantoni pikat kryesore të draft buxhetit gojarisht, në një mënyrë që njerëzit ta kuptojnë. U shtroni pyetje qytetarëve në fushat në të cilat do të donit të merrnit të dhëna prej tyre. Gjatë takimit, angazhoni një **moderator të mirë**, që iu jep hapësirë njerëzve të ndryshëm të flasin, grave dhe burrave, dhe që nuk lejon asnjë person që të marrë kontrollin gjatë takimit. Caktoni një person tjetër që të mbajë shënime të qarta për çështjet e ngritura nga qytetarët. Kur është e mundur, përgjigjuni aty për aty në pyetjet, shqetësimet, apo çështjet e ngritura nga qytetarët, gratë dhe burrat. Nëse nuk keni informata të mjaftueshme, bëjuni me dije qytetarëve që do t'iu përgjigjeni publikisht në të ardhmen, duke specifikuar se kur dhe ku do t'i përgjigjeni.

Vazhdimësia: Për qytetarët është e rëndësishme që si zgjedhësit tuaj, të dijnë se çfarë është bërë me informatat që ata iu kanë dhënë gjatë takimit. Kur e kuptojnë që ajo çka kanë thënë është dëgjuar, kjo iu jep vullnet që të marrin pjesë në procese të tilla. Dërgoni një kumtesë për media

menjëherë pas takimit dhe postoni informatat në faqen tuaj të internetit, në mënyrë që të informoni të gjithë qytetarët (edhe ata që nuk kanë qenë prezent) për çështjet që janë prezantuar dhe diskutuar. Përfshini informatat kontaktuese të personave që ata mund t'i kontaktojnë nëse duan të shtrojnë pyetje apo të ndajnë më shumë ide (brenda një afati të caktuar). Më vonë, dërgoni një tjetër kumtesë për media dhe reklamoni mirë se cilat çështje të ngritura nga qytetarët, gratë dhe burrat, janë përfshirë në buxhet.

Çka nëse hasi në sfida?

Kjo pjesë përshkruan sfidat e mundshme me të cilat dikush mund të ballafaqohet gjatë “kryerjes së BPGJ-së”, si dhe disa mënyra të mundshme se si t’i adresojmë sfidat e tilla.

Sfida	Zgjidhja e mundshme
Nuk ka të dhëna të ndara sipas gjinisë	<ul style="list-style-type: none">• Sigurohuni që institucioni juaj në të ardhmen të filloj të ndajë të gjitha të dhënat sipas numrit të grave dhe burrave (si dhe grave dhe burrave në nën-grupe, p.sh. bazuar në moshën, nivelin e arsimimit, etnicitetin etj, kur një ndarje e tillë ka kuptim), në mënyrë që mos ta keni këtë problem në të ardhmen.• Ku është e mundur, përdorni censusin e vendit, ose studimet apo raportet e tjera, që kanë të dhënat të cilat ju nevoiten.• Kryeni një pyetësor të shpejtë me një mostër të vogël të përfituesve, që më vonë mund të gjeneralizohet në popullsinë e përfituesve.• Bëni hulumtim cilësor, duke përfshirë fokus grupet dhe/ose intervistat për

	<p>të mbledhur informatat.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Mungesa e të dhënave nuk duhet të përdohet si arsyetim për të mos kryer BPGJ. Gjithmonë egziston një mënyrë për t'ia filluar, edhe nëse kemi pak të dhëna. Më pas, përmes analizave të ndryshme, do të krijohen të dhëna të reja.
<p>Mungesa e vullnetit politik për zbatimin e BPGJ-së</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Qasjuni personave në pozita vendimmarrëse që prej fillimit (p.sh. ministrave, udhëheqësve të departamenteve) për t'iu shpjeguar rëndësinë e BPGJ-së për ministrinë. Mos harroni të përmendni se kjo nuk ka të bëjë vetëm me gratë dhe që jodomosdoshmërisht ka nevojë për rritje të linjës buxhetore (këto janë dy keqkuptimet më të shpeshta). Nëse ata e kuptojnë këtë dhe rëndësinë e BPGJ-së në planifikimin buxhetor, ata do të mund t'iu përkrahin, dhe të tjerët me siguri do të ndjekin këtë shembull. • Mirësisht kërkoni nga personat udhëheqës një letër mbështetëse për analizën gjinore, që do të mund t'iu ndihmojë në qasjen tek departamentet dhe divizionet tjera.

	<ul style="list-style-type: none"> • Shpjegojuni zyrtarëve që BPGJ mund të rrisë efikasitetin, efektivitetin, llogaridhënien, dhe transparencën e ministrisë. Procesi mund të rezultojë në dëshmi të qarta të cilat ata mund t'i përdorin në arsyetimin e kërkesave të tyre buxhetore tek Ministria e Financave, duke ofruar një mundësi më të mirë që kërkesat të financohen. • BPGJ mund t'iu ndihmojë atyre që të paraqesin tek akterët ndërkombëtarë dhe vendor përkushtimin e tyre për avansimin e barazisë gjinore. • Bëjuni të qartë që kryerja e BPGJ-së është obligim ligjor.
<p>Mungesa e kapacitetit për të kryer analiza gjinore</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Kërkoni përkrahje, sugjerime dhe/ose mentorim prej Agjencisë për Barazi Gjinore, Zyrtarëve për Barazi Gjinore, Rrjetit të Grupeve të Grave të Kosovës, organizatave të shoqërisë civile, dhe/ose akterëve ndërkombëtarë që kanë përvojë në zbatimin e BPGJ.
<p>Nuk ka buxhet për të arritur</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Përdorni analizat gjinore për të bërë argumente të qarta në dokumentin buxhetor, duke justifikuar

**objektivat e
identifikuara
drejt
barazisë
gjinore**

shpenzimet e tepërta tek Ministria e Financave.

- Nëse kërkesa për fonde është mohuar, kërkoni përkrahje financiare apo vetanake (pa të holla) nga akterët ndërkombëtarë, donatorët, ose akterët e shoqërisë civile, për zbatimin e objektivave.
- Në përgjithësi, bëjeni të qartë që BPGJ nuk përfshin fonde shtesë, por ka për qëllim përdorimin më efikas të fondeve ekzistuese. Duke marrë parasysh perspektivat e grave dhe burrave, objektivat për barazi gjinore do të arrihen më lehtë duke shpenzuar fondet e rregullta në mënyrë më të mirë.

**Pak gra
marrin pjesë
në dëgjime
publike /
konsultime**

- Shpërndani sa më shumë që të jetë e mundur informatat lidhur me kohën dhe vendin se ku do të mbahet dëgjimi publik.
- Postoni informatat në postera, në faqen e internetit, dhe në media.
- Hartoni strategji të komunikimit, e cila synon dhe arrin edhe tek gratë.
- Drejtojuni në mënyrë direkte grave: shpjegojuni se si pjesëmarrja e tyre aktive mund të ketë ndikim në jetët e tyre dhe të kryejë aktivitete fuqizuese.

“Sigurisht që do të hasim në sfida, por nëse jemi të përkushtuar që të krijojmë një shoqëri më të barabartë dhe nëse punojmë së bashku, ne mund ta arrijmë këtë!”



Afatet kryesore në proceset buxhetore

Për BPGJ, koha dhe koordinimi me afate buxhetore janë shumë të rëndësishme. Prandaj, kjo pjesë e doracakut bënë përmbledhjen e afateve kryesore buxhetore për nivelin qëndror.

Data	Veprimi
15 Prill	Ministria e Financave përgatit KASH-in për tri vitet e ardhshme.
30 Prill	Qeveria dërgon KASH-in për vitin e ardhshëm fiskal tek Parlamenti i Kosovës, dhe llogaritë buxhetin për dy vitet e ardhshme fiskale.
30 Prill	Qarkorja Buxhetore finalizohet në këtë datë. MF e dërgon atë tek organizatat buxhetore.
15 Qershor	Bazuar në KASH, organizatat buxhetore dërgojnë buxhet propozimet e tyre.
15 Qershor - 31 Tetor	Ministria e Financave dhe organizatat buxhetore organizojnë dëgjime publike (zakonisht gjatë muajve Korrik dhe Gusht).
31 Tetor	Ministria e Financave e dërgon buxhetin për aprovim tek qeveria.
31 Tetor	Qeveria e miraton buxhetin e propozuar dhe e dërgon atë tek Parlamenti i Kosovës.
Nëntor – Dhjetor	Parlamenti e diskuton buxhetin
31 Dhjetor	Parlamenti miraton buxhetin e Kosovës.

A doni më shumë informata dhe mjete të dobishme?

Alterziu B. *Eksperiencia Buxhetimi gjinor në Bashkinë e Elbasanit: Buxhetimi me pjesëmarrje*. Prezantim. Në: http://www.partnersalbania.org/skedaret/Elbasani_shqip.pdf

HELVETAS. *Konferenca Ndërkombëtare: Buxhetimi i Përgjegjshëm Gjinor: Sfidat dhe Praktikak*. Prishtinë, Kosovë, 15 Nëntor 2012. Në: <http://abgj.rks-gov.net/Portals/0/International%20Conference%20Alb.pdf>

Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës. *Buxhetimi drejt Mirëqenies Sociale. 2014*. Në: <http://www.womensnetwork.org/documents/20140702111943317.pdf>

_____. *Me Çfarë Çmimi: Alokimet Buxhetore për Zbatimin e Kornizës Ligjore kundër Dhunës në Familje në Kosovë*. 2012. Në: <http://www.womensnetwork.org/documents/20130211130931258.pdf>

Shoqata Afariste e Gruas SHE-ERA. *Analiza e Buxhetit Gjinor dhe Ndikimi i Politikave Fiskale në Nivelin e Varfërisë së Grave Fermere – Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural*. 2007. Në: <http://she-era.org/~sheera/wp-content/uploads/2014/05/ANALIZA-E-BUXHETIT-GJINOR-DHE-NDIKIMI-I-POLITIKAVE-FISKALE-N%C3%8B-NIVELIN-E->

[VARF%C3%8BRIS%C3%8B-S%C3%8B-GRAVE-FERMERE-%E2%80%93-MINISTRIA.pdf](#)

Swiss Cooperation Office në Kosovë. *Gjinia në Planet dhe Buxhetet Komunale: Doracak me udhëzime praktike për një Planifikim të Përgjegjshëm Gjinator dhe Buxhetim në Nivel lokal bazuar në përvojat me komunat e Kosovës*. 2012. Në: <http://helvetas-ks.org/wp/wp-content/uploads/2011/10/Gender-Manual-SQ.pdf>

USAID Democratic Effective Municipalities Initiative (DEMI). *Buxhetimi i Përgjegjshëm Gjinator: Nga verpimet Ad-hok tek integrimi dhe Planifikimi Gjinator*. Në: http://www.demi-ks.org/repository/docs/GenderResponsiveBudgeting_Alb.pdf

USAID DEMI. *Policy Paper on Municipal Gender Responsive Budgeting in Kosovo*. 2013.

Zenelaj B. *Veglat e Panifikimit*. Academy for Training and Technical Assistance. (Prezantim)

Katalogimi në botim – (CIP)

Biblioteka Kombëtare e Kosovës “Pjetër Bogdani”

305-055.1(496.51)(036)

305-055.2(496.51)(036)

330.534.4(496.51)(036)

Udhërrëfyes Praktik : Buxhetimi Përgjegjshëm
Gjinor në Nivel Qendror : Buxheti i Kosovës / Nicole
Farnsworth... [et al.]. – Prishtinë : Rrjeti i Grupeve të
Grave të Kosovës, 2014. – 60 f. : ilustr. me ngjyra ; 21
cm.

I.Farnsworth, Nicole

ISBN 978-9951-8852-1-8

Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës

Rr. Hajdar Dushi C-2 II/8

10000 Prishtinë, Kosovë

+ 381 (0) 38 245 850

www.womensnetwork.org

info@womensnetwork.org

[Facebook: Kosova Women's Network](https://www.facebook.com/Kosova-Women's-Network)

ISBN 978-9951-8852-1-8



9 789951 885218